



# SBASHK

## Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

# Arsimimi

### KULTURA E NJERIUT



*Ë-buletin*

*Mars, 2019*

**SBASHK lartëson kujtimin për pishtarët e dijes Manifestim madhështor kushtuar ditës së mësuesit dhe shkollës shqipe**



Sa herë vjen marsi SBASHK-u zhvillon aktivitete të shumta në nivel komuna e në atë qendror për të lartësuar kujtimin për pishtarët e dijes. Edhe këtë vit janë zhvilluar shumë aktivitete kulturore në institucionet e arsimit të Kosovës dhe në përmbyllje të këtij angazhimi në respekt të 7 Marsit - ditës së mësuesit dhe shkollës shqipe, SBASHK ka organizuar një Manifestim madhështor në Pallatin e sporteve "1 Tetori" duke bërë bashkë më shumë se 600 pishtarët e dijes që janë pensionuar nga prilli vitit të kaluar e deri në marsin e këtij viti. Në shenjë të respektit e duke çmuar lart angazhimin e tyre në edukimin e arsimimin e brezave SBASHK atyre u ka ndarë nga ... (faqe 5)

**Mësimdhënësit unik në vendimin e Këshillit Drejtues**



Nuk ka kompensim orësh as në pushimin pranveror ... (faqe 11)



**Intervistë me Ramiz Polaci mësimdhënës i gjuhës shqipe dhe letërsisë. Ai është shumë i respektuar ... (faqe 3)**

**Kryetarët e nivelit komunal raportojnë nga komunat e tyre**



**Orët e humbura gjatë grevës mos të zëvendësohen**

Në përpjekje për ta vënë në jetë vendimin e pabazuar në Ligj për zavendesimin ... (faqe 8)

**Sqarim i SBASHK-ut lidhur me vendimin e Gjykatës Themelore**

# SBASHK



SINDIKATA E BASHKUAR E ARSIMIT, SHKENCËS DHE KULTURËS

**Nuk është refuzuar padia ndaj vendimit të Ministrit**

Opinionin e di se SBASHK-u duke konsideruar si të pabazuar në Ligj vendimin e Ministrit Bytyqi ka ngritur padi ndaj këtij ... (faqe 7)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës  
The Union of Education, Science and Culture

## Editorial

### Urim i gazetës “Arsimimi sot” për ditën e madhe të shkollës shqipe



Të nderuar pishtarë të dijes, kolege e kolegë 7 Marsi është një datë e rëndësishme e kombit tonë që shënon nismën e betejave të mëdha të njerëzve të dijes në mbrojtje të dritës nga errësira. Në këtë ditë lartësojmë kujtimin për mësuesit e parë të kombit dhe shprehim respektin meritore për punëtorët e arsimit shqip

në shërbim të edukimit e arsimimit të brezave.

Shprehim respektin e lartë dhe i përkulemi kujtimin për mësuesin e dëshmorin Shaban Jashari dhe për kolegët tanë që në vitet 90-ta mbrojnë arsimin dhe shkollën shqipe nga furtunat e pushtuesit. Ata me mund e sakrifica kanë vënë gurët

themeltar të Kosovës shtet. Të nderuar pishtarë të dijes në këtë 7 Mars jemi ballëhapur sepse pas shumë përpjekjeve e kemi Ligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta, i cili shpreh mirënjohjen dhe përkrahjen për gjithë ata që me kanë dhënë kontribut të lartë në shërbim të arsimit dhe atdheut.

Të nderuar pishtarë të dijes, kolege e kolegë bashkë e në SBASHK do të vazhdojmë rrugëtimin në përpjekjet e vazhdueshme për realizimin e

shërbim të një arsimit edhe më cilësor.

Gëzuar dhe urime 7 Marsi, kjo ditë e madhe e mësuesit dhe shkollës shqipe. Urime dhe e gëzofshim bashkë Ligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

[www.sbashk-rks.org](http://www.sbashk-rks.org)

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

**Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)**

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e

përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: [info@sbashk-rks.org](mailto:info@sbashk-rks.org)

Tel. +381(0)38/ 226 940



## Intervista

Inervistë me Ramiz Polacin, kryetar i SAF e SAM në Skenderaj

### **Puna e mësimdhënësit është mision i shenjtë**



**Ramiz Polaci është mësimdhënës i gjuhës shqipe dhe letërsisë. Ai është shumë i respektuar nga të gjithë për arsye se angazhohet shumë në realizimin e detyrave si punëtor arsimit dhe si kryetar sindikate në Skenderaj “Puna e mësimdhënësit nuk është e vështirë po**

**pate përkushtim dhe ngritje të duhur profesionale. Vështirësitë na imponohen nga të tjerët, si eksperimentet, reformat dhe kurikulat të ndryshme në arsim”, e thotë në intervistën për gazetën tonë kolegu Ramiz.**

**Arsimimi sot:**

**Kush është Murat Bytyqi?**

**Ramizi:**

Jam Ramiz Polaci, i lindur më 21.07.1957 ne fshatin Polac, ku kam kryer shkollën fillore dhe pastaj gjimnazin ne Skenderaj. Gjatë viteve 1976-80 kam studiuar Letërsinë dhe Gjuhën Shqipe në Universitetin e Prishtinës. Prej vitit 1981 punoj ne Gjimnazin "Hamez Jashari" ne Skenderaj. Jam i martuar dhe kemi dy djem. Themelues i Degës se SBASHK-ut në Skenderaj dhe kryetar i saj nga viti 2006.

**Arsimimi sot:**

**Sa është i vështirë profesioni i mësimdhënësit sot?**

**Ramizi:**

Puna e mësimdhënësit nuk është e vështirë po pate përkushtim dhe ngritje të duhur profesionale. Vështirësitë na imponohen nga të tjerët, si eksperimentet, reformat dhe kurikulat të ndryshme në arsim.

**Arsimimi sot:**

**Çka do të veçonit nga aktivitetet dhe arritjet e SBASHK-ut?**

**Ramizi:**

Gjatë rrugëtimit SBASHK-u ka pasur shumë aktivitete dhe suksese. Nga aktivitetet do të veçoja përfshirjen

masovike te mësimdhënësve në sindikatë dhe organizimi i trajnimeve për mësimdhënës. Pastaj pjesëmarrja dhe anëtarësimi në shumë konferenca e organizata ndërkombëtare. Kurse arritjet më të mëdha te SBASHK-ut janë nënshkrimi i Kontratës Kolektive me MASHT-in, aprovimi në Parlament i Ligjit për paga dhe i Ligjit për punën e mësimdhënësve gjatë viteve '90.

**Arsimimi sot:**

**Çka i sugjeroni SBASHK-ut që të fokusohet më shumë në angazhimet e veta?**

**Ramizi:**

Përmirësimi i kushteve të punës, aprovimi i Ligjit të sigurimit shëndetësor si dhe realizimi në plotëni i të drejtave ligjore që dalin nga Ligji i punës dhe Kontrata Kolektive, duhet të jetë fokusimi i SBASHK-ut në të ardhmen.

**Arsimimi sot:**

**Si ndiheni si Kryetar i Sindikates Komunale për komunen tuaj?**

**Ramizi:**

Te qenit kryetar i Sindikatës komunale do të thotë sfida, aktivitete e përgjegjësi. Unë ndihem rehat ne këtë pozitë, sepse kam arritur të krijojë raporte të mira me anëtarësinë, kryesinë e shoqatave, kryesinë e Degës dhe me pushtetin komunal. Gëzohem kur mësimdhënësve u ndihmoj në realizimin e drejtave të tyre.

**Arsimimi sot:**

**Çka do të veçonit nga të arriturat në Komunën e Skenderait?**

**Ramizi:**

Nga sistemi komunist jugosllav Skenderaj ka trashëguar varfëri dhe shtypje të vazhdueshme. Edhe gjate luftës se fundit Skenderaj doli komuna më e shkatërruar dhe e viktimizuar. U desht shumë punë e investime për të ndërtuar infrastrukturën rrugore, furnizim me ujë te pijshëm, kanalizime për ujëra të zeza dhe shumë objekte shkolllore e kulturore, te cilat i konsideroj të arriturat kryesore ne komunën tonë. Po ashtu do theskuar se janë shënuar arritje të mira edhe në angazhimet sindikale.

# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

## **Arsimimi sot:**

**Çka ju sugjeroni mësimdhënësve që nuk janë aktiv sa duhet në SBASHK?**

## **Ramizi:**

Aktivizohuni, zgjidhni ose zgjidhuni në pozita të ndryshme sindikale, sepse në këtë mënyrë do t'i realizoni të drejtat tuaja por edhe të tjerëve. Sidomos të rinjëve ju sugjeroj mos të hezitojnë të marrin përgjegjësi sindikale.

---

## **Arsimimi sot:**

**A keni diçka për të shtuar?**

## **Ramizi:**

Te jemi kompetent në punë dhe në sindikatë. Mos të dorëzohemi para problemeve dhe vështirësive momentale. Vetëm te bashkuar i realizojmë të drejtat tona ligjore.

---



## Gjatë muajit

SBASHK lartëson kujtimin për pishtarët e dijes

### Manifestim madhështor kushtuar ditës së mësuesit dhe shkollës shqipe



Sa herë vjen marsi SBASHK-u zhvillon aktivitete të shumta në nivel komuna e në atë qendror për të lartësuar kujtimin për pishtarët e dijes. Edhe këtë vit janë zhvilluar shumë aktivitete kulturore në institucionet e arsimit të Kosovës dhe në përmbyllje të këtij angazhimi në respekt të 7 Marsit - ditës së mësuesit dhe shkollës shqipe, SBASHK ka organizuar një Manifestim madhështor në Pallatin e sporteve "1 Tetori" duke bërë bashkë më shumë se 600 pishtarët e dijes që janë pensionuar nga prilli vitit të kaluar e deri në marsin e këtij viti. Në shenjë të respektit e duke çmuar lart angazhimin e tyre në edukimin e arsimimin e brezave SBASHK atyre u ka ndarë nga një orë dore dhe mirënjohje.



"Punëtorët e arsimit as edhe një herë nuk i kanë mbetur borxh atdheut. Ata në kohët më të vështira e kanë mposhtur errësirën dhe i kanë hapur rrugë dritës. Ata në zemër kanë ruajtur alfabetin, kulturën, arsimin dhe kanë mbajtur gjallë ëndrrën për liri, që falë bijave e bijve më të mirë të këtij trualli dhe ndihmës së

miqve të vërtetë u kthye në realitet. Tani kur Kosova frymon lirshëm dhe tingëllon bukur zilja e shkollës dhe dëgjohet buzëqeshja e zëri i lumtur i nxënësve ndjehemi edhe më shumë krenar me punën e përkushtimin që ju bëtë gjatë gjithë viteve e dekadave për arsimimin e brezave" është shprehur Nezafete Jakupi në hapje të këtij manifestimi për të përshëndetur pastaj z. Ismajl Kurteshi, kryetar i Komisionit Parlamentar për Arsim, Agim Hasanin nga Bujanovci, deputetin shqiptar të Luginës së Preshevës, z. Fatmir Hasasni, kryetarin e BSPK-së, Avni Hajdini, nënkryetarin Atdhe Hykolli, anëtarin e kryesisë Rashit Mehmeti dhe kryetarin Ansambit Autokton "Rugova", z. Vesel Nikçi.



"Sa herë vjen muaji mars njeriu spontanisht nis e i thotë vargjet e këngës "Sërisht vjen marsi" dhe me një dhembje krenare kujton ngjarjet e ndodhura në këtë muaj nëpër vite e dekada. Marsi shënoi nisjen e rrugëtimit të popullit për shkaputje nga robëria, marsi shënoi aktin sublim të luftës e sakrificës së familjes Jashari në Prekazin e historisë, marsi shënoi rrugëtimit drejt dritës e kundër errësirës me hapjen e shkollës së parë shqipe. Marsi nëpër vite, dekada e shekuj shënoi edhe shumë data e ngjarje me rëndësi. Të nderuar pishtarë të dijes, krahas shumë aktiviteteve e angazhimesh, SBASHK edhe këtë vit organizoi këtë Manifestim për të bërë bashkë e në një festë pishtarët e dijes që janë pensionuar nga prilli i vitit të kaluar e

# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

deri në marsin e këtij viti. Është ky një moment i mirë për shpалosjen e kujtimeve nëpër vite duke rrugëtuar bashkë me brezat drejt diturive e arritjeve të reja.



Urime të gjithë të punësuarve në sektorin e arsimit dita e madhe e mësuesit dhe shkollës shqipe. Urime Ligji për statutin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta", është shprehur kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj.



Ka shprehur respekt të lartë për pishtarët e dijes, që sot po merrnin mirënjohje për punën e përkushtimin e tyre, kryetari i Komisionit Parlamentar për Arsim, z. Ismajl Kurteshi. Ai ka kujtuar vitet e vështira të okupimit të Kosovës dhe ka shprehur respekt të lartë për njerëzit e dijes së asaj kohe që mbajtën gjallë

arsimin shqip duke e mbrojtur atë nga furtunat e pushuesit.



Fjalë respekti meritor për mësime dhënësit e pensionuar dhe për gjithë armatën e dijes ka shprehur edhe kryetari i BSPK-së, Avni Ajdri dhe mysafirët e nderuar nga Kosova Lindore, të cilët kanë thënë se kjo ditë është e madhe dhe se SBASHK-u duke bërë angazhime të vazhdueshme në shërbim të arsimit ka organizuar këtë manifestim shumë domethënës në shprehje të respektit për pishtarët e dijes.



Kanë përshëndetur pishtarët e lirisë edhe Agim Hasanin nga Bujanovci dhe deputeti shqiptar të Luginës së Preshëves, z. Fatmir Hasasni, të cilët kanë kujtuar edhe situatën aktuale në Kosovën Lindore duke kërkuar bashkëpunim dhe përkrahjen e vazhdueshme nga Kosova për ta.

Edhe kryetari i Ansambllit "Autokton" "Rugova" ka shprehur respekt të lartë për njerëzit e arsimit dhe për kontributin e tyre nëpër vite, dekada e shkuaj. Ky ansambël me traditë 70 vjeçare në kultivimin valles së bukur autoktone shqipe ka nisur një program artistik, që filloi me humoristin Fadil Grabovci e për të vazhduar me valle të Ansambllit që janë pëlqyer shumë dhe janë përkrahur me duartrokitje të gjata.



Në pjesën e dytë të Manifestimit janë ndarë mirënjohjet dhe orët për punëtorët e arsimit që kanë punuar me dekada në arsimin e brezave e që janë pensionuar nga prilli i vitit të kaluar e deri në marsin e këtij viti.

Me radhe kanë përcjell këtë Manifestim kushtuar pishtarëve të dijes.

Kryetari Jasharaj në mbyllje të Manifestimit ka falënderuar drejtorin dhe stafin e Qendrës së studentëve studentëve për ndihmën që i kanë bërë

Manifestimit duke lejuar që kjo festë të mbahet në Pallatin e sporteve dhe mediet që, si gjithmonë, edhe kësaj radhe kanë përcjell këtë Manifestim kushtuar pishtarëve të dijes. Po ashtu ai ka falënderuar stafin e SBASHK-ut, Ymer Ymerin, Rrezarta Bahtjarin, Blendor Shatrin, Nezafete Jakupin, Afërdita Ahmetin, Lutfi Manin dhe Vjollca Shalën për angazhimet maksimale në përgatitjen sa më të mirë të këtij Manifestimi.



## Sqarim i SBASHK-ut lidhur me vendimin e Gjykatës Themelore Nuk është refuzuar padia ndaj vendimit të Ministrit


Opinionin e di se SBASHK-ut duke konsideruar si të pabazuar në Ligj vendimin e Ministrit Bytyqi ka ngritur padi ndaj këtij vendimi në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Individë e institucione ishin mundur të krijojnë paqartësi në opinion duke shpërndarë të pavërtetën se gjoja Gjykata ka refuzuar padinë e SBASHK-ut. Por, pa vonuar ka dalur publikisht sqarimi i SBASHK-ut në të cilin thuhet se Departamenti për çështje administrative i Gjykatës Themelore në Prishtinë sot ka nxjerr një vendim që ka të bëjë me njërin nga kërkesat e SBASHK-ut që i janë drejtuar

kësaj Gjykate më 4 mars e që kanë të bëjnë me Padi-kërkesën ndaj vendimit të MASHT-it lidhur me kompensimin e orëve të humbura gjatë grevës. SBASHK-u në Padi-ankesë kishte ngritur dy çështje:

1. Padi ndaj vendimit të pabazuar në ligj të MASHT-it dhe
2. Kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të këtij vendimi deri në vendimin e plotfuqishëm të Gjykatës.

Pra, Gjykata nuk ka aprovuar kërkesën e SBASHK-ut për shtyrjen e pezullimin e përkohshëm të vendimit të MASHT-it lidhur me orët e humbura gjatë grevës, por ka cekur se kjo nuk prejudikon vendosjen meritorë të aktvendimit për padinë e SBASHK-ut ndaj MASHT-it.

SBASHK uron që Gjykata të caktojë seancë në kohën sa më të shpejtë të mundur lidhur me padinë ndaj vendimit të pabazuar të MASHT-it dhe të merr vendim meritor konform argumenteve e fakteve të ofruara nga SBASHK-u.



Kryetarët e nivelit komunal raportojnë nga komunat e tyre

## Orët e humbura gjatë grevës mos të zëvendësohen



Në përpjekje për ta vënë në jetë vendimin e pabazuar në Ligj për zëvendësim të orëve të humbura në grevë kishin nisur edhe presione të caktuara në disa komuna e shkolla nga drejtorë të DKA-ve apo të ndonjë shkolle. Kjo ka bërë që të mbahet edhe një takim konsultativ me kryetarët e Kuvendeve të Sindikatave të SAF e SAM të komunave të Kosovës dhe të SUSHK.

Edhe në këtë takim të pranishmit duke përcjellë zërin e punëtorëve të arsimit nga komunat e tyre në mënyrë unanime kërkuan që të zbatohet vendimi i Këshillit Drejtues i SBASHK-ut që orët e humbura gjatë grevës mos të zëvendësohen as të shtunave, as pushimit pranveror e as në fund vitit.

Kjo vendosmëri e udhëheqësve sindikal dhe kryesisë së SBASHK-ut qëndron në bindjen e tyre se asnjë dokument juridik nuk na obligon mbajtjen e orëve të humbura gjatë grevës e aq më tepër ku secili mësimdhënës në kontratën individuale të punës ka për

obligim të mbajë 20 orë mësimore në javë e këto 20 orë mësimore të realizohen nga e hëna deri të premten.

Gjatë raportimit nga kryetarët e sindikatave komunale u vërejt se një numër i komunave përmes drejtorëve të arsimit dhe drejtorëve të shkollës janë duke u bërë presion mësimdhënësve por edhe nxënësve në forma të shantazheve për t'i detyruar që të mbahet mësimi ditëve të vikendit ( të shtunave). Nga takimi u vendos që publikisht SBASHK t'i drejtohet kryetarëve të kuvendeve komunale drejtorive arsimore dhe drejtorëve të shkollave që mos të bëjnë presion tek mësimdhënësit për mbajtjen e orëve gjatë ditës së shtunë sepse ata kështu shkelin kontratën e punës që e kanë lidhur vetë komunat me punëtorët e arsimit e siç e cekëm më lartë mësimdhënësit duhet ti mbajë 20 orë mësimore në javë. Në këtë shkresë të bërë publike SBASHK-u ka përsëritur se do të vazhdojë të jetë në mbrojtje të anëtarësisë dhe do të reagojë fuqishëm ndaj çdo presioni që kusho qoftë do ia bëjë mësimdhënësve.

SBASHK po ashtu ka apeluar te anëtarët e SBASHK-ut që të jenë unik në zbatimin e vendimeve të organeve të SBASHK-ut ashtu siç ishin unik edhe gjatë realizimit të grevës, kurse Ministrin Bytyqi ia kanë përsëritur kërkesën që ta tërheq vendimin lidhur me kompensimin e orëve, ngase siç është parë, ky vendim e ka çrregulluar procesin mësimor edhe gjatë ditëve tjera të punës.

SBASHK-u ju drejtohet zyrtarisht kryetarëve të Komunave të Kosovës

## Me presione vetëm sa përkeqësohet situata në arsim

Ashtu si ishte vendosur në takimin e Këshillit Drejtues dhe në takimin konsultativ me kryetarët e Kuvendeve të SAF e SAM të komunave të Kosovës dhe Universitetive, SBASHK-u u është drejtuar zyrtarisht kryetarëve të kuvendeve komunale drejtorive arsimore dhe drejtorëve të shkollave që mos

të bëjnë presion tek mësimdhënësit për mbajtjen e orëve gjatë ditës së shtunë. Në këtë shkresë zyrtare veç tjerash thuhet:

" Duke parë se javët e fundit është bërë një çrregullim i madh i procesit arsimor në disa Komuna të Kosovës, e këtë çrregullim e ka krijuar vendimi i ministrit



z. Shyqiri Bytyqi për zëvendësimin e orëve të humbura gjatë grevës, SBASHK-u si përfaqësuese i punonjësve të arsimit të komunave tuaja duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin mbi organizimin Sindikal Nr. 04/L-011, Ligjin mbi grevën nr Nr. 03/L-200 dhe Statutin e SBASHK-ut, si dhe Kontratën Kolektive të Arsimit nënshkruar nga MASHT dhe SBASHK, më 18. 04. 2017, Ndjejmë për obligim që t'ju drejtohem me këtë shkresë duke pasur parasysh të gjithë drejtorët e drejtorive arsimore janë të emëruar nga ju dhe normalisht për punën e tyre duhet t'ju raportojnë juve. Gjithashtu edhe drejtorët e shkollave ishte dashur t'i raportojnë nivelit komunal. Ditëve të fundit një pjesë e tyre kanë ndërmarr një fushatë të presionit të mësimdhënësve për ti detyruar që t'i zëvendësojnë orët e humbura gjatë grevës e duke u mbështetur në vendimin e MSHAT-it, të cilin vendim SBASHK-u e ka kontestuar dhe e ka dërguar në gjykatë për ta vlerësuar ligjshmërinë e tij sepse ne vlerësojmë me të drejt se është vendim i pa bazuar në Ligj, pasi që asnjë ligj apo dokument juridik valid i Republikës së Kosovës, e as normë ndërkombëtare nuk ekziston që thotë se orët e humbura gjatë grevës

duhet zëvendësuar", thuhet, veç tjerash në këtë shkresë.

SBASHK në shkresën zyrtare drejtuar kryetarëve të komunave i kujton ata se nëse ky presion në disa Komuna vazhdon edhe gjatë këtyre ditëve, por edhe gjatë pushimit pranveror, ju njoftojmë se SBASHK-u mund të shpallë grevë të përgjithshme duke kërkuar tërheqjen e vendimit për zëvendësimin e orëve si dhe përgjegjësinë ndaj atyre që kanë ushtruar presion. Kjo grevë mund të prodhojë edhe ditë të tjera të humbura të mësimit, përveç këtyre 15 ditëve që janë humbur gjatë grevës". Përmbajtja e shkresës i është dërguar edhe medieve të nderuara.



## SBASHK-u me kërkesë konkrete në takimin ne Ministrin Të përmirësohet koeficienti i mësuesve



**Nëse MASHT dhe deputetët në një seancë të parlamentit ndryshojnë koeficientet për mësimdhënësit e ciklit klasor dhe e barazojnë me ato të mësimdhënësve të ciklit lëndor, atëherë për hir të kolegëve të ciklit klasor kryesia e SBASHK-ut do të apelojë te mësimdhënësit e Kosovës që të zëvendësojnë mësimin për një javë në fund të vitit**

## mësimor. Kjo është thënë në takimin me Ministrin Bytyqi dhe zëvendësministrin Arbër Geci.

Në këtë takim u diskutua rreth situatës aktuale të krijuar në arsimin parauniversitar të Kosovës. Kryetari i SBASHK-ut paraqiti qëndrimin e Këshillit Drejtues të SBASHK-ut, të cilët janë të vendosur ta presin vendimin përfundimtar të gjykatës pasi janë të mendimit që verdikti përfundimtar do të jetë në favor të tyre. Kryetari i SBASHK-ut në këtë takim paraqiti edhe një mundësi para Ministrin Bytyqi që kjo gjendje të zhbllokohet nëse Ministri Bytyqi bashkërisht me deputetët e partisë Nisma Socialdemokrate dhe deputetët e partive tjera të ftojnë një seancë të jashtëzakonshme me qëllim të përmirësimit të koeficientit për mësimdhënësit e ciklit fillor 1 deri 5 në Ligjin e pagave dhe të barazohet me koeficientin e

zyrtare, ndërsa zbatimi i tij fillon në fund vit dhe në këtë rast SBASHK do të merr për obligim të bisedoj me mësimdhënësit që në fund vitin shkollor 2018/2019 të zëvendësojnë një javë në shenjë të vullnetit të mirë për mësimdhënësit e ciklit fillor 1-5. Ky propozim i SBASHK-ut në mënyrën më dinjitoze është prezantuar edhe në takimin e Komisionit

Parlamentar për Arsim nga nënkryetarja e SBASHK-ut Vjollca Shala dhe kryetari i Kuvendit të Arsimit Fillor e të Mesëm të Ulët, Blerim Mehmeti. Këshilli Drejtues do të ketë takimin e radhës dhe do të jetë i informuar gjerësisht lidhur me takimin e Komisionit Parlamentar.

## SBASHK-u apel publik drejtuar të zgjedhurve të popullit Deputetë mbron ligjin dhe mos cenoni pavarësinë gjykatave



**Për tri javë grevë nuk ishte parë e rrugës të mbledheshin nënshkrime e të thirrej mbledhje e jashtëzakonshme e Parlamentit të Kosovës, por për orët e humbura në grevë kjo ndodhi. SBASHK-u duke vepruar sipas situatës së re të krijuar u është drejtuar publikisht deputetëve të Republikës së Kosovës me apelin që ata t'i respektojnë ligjet, konkretisht edhe ligjin e grevave.**

“Të nderuar deputetë Ligji për grevat i Republikës së Kosovës e njuh grevën si veprim demokratik dhe nuk obligon grevistët që orët a ditë e humbura në grevë të kompensohen. Ministri Bytyqi nxori një vendim të pabazuar në ligj dhe bashkë me një pjesë të Drejtorëve të Drejtorive Arsimore e të disa shkollave filluan një presion të paparë ndaj mësimdhënësve për kompensim të orëve të humbura në grevë. SBASHK duke e konsideruar me të drejtë këtë vendim jo ligjor ngriti padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë duke kërkuar që institucioni i drejtësisë të vlerësojë ligjshmërinë e këtij vendimi dhe SBASHK-u publikisht është deklaruar se do ta respektojë verdiktin e gjykatës.

Mendojmë se çdo diskutim më parlament në dobi të vendimit joligjor të Ministrit Bytyqi do të ishte ndërhyrje dhe presion në institucionin e drejtësisë.

Deputetë të nderuar ju sot është më mirë të diskutoni

për mungesën e kabinetëve të informatikës, kimisë, fizikës e lendeve të tjera, për mungesën e sallave të edukatës fizike, për gjendjen e mjerë të nyjave sanitare, pra për mungesën e kushteve elementare të punës në shumicën e shkollave të Kosovës, mungesa këto që ndikojnë shumë në procesin mësimor e edukativ se sa të merreni me një vendim jo ligjor të Ministrin Bytyqi.

Sot duhet t'i qortoni Ministrin dhe një pjesë të drejtorëve, të cilët duke bërë presione për zëvendësimin e orëve të humbura në grevë, por pengojnë procesin mësimor. Duhet t'i qortoni e të merrni masa ndaj drejtorëve, si rasti në Mitrovicë, kur drejtori jep urdhër me shkrim, që duhet zëvendësuar orët edhe për ditët që mësimdhënësi ka qenë i sëmurë dhe në pushim mjekësor. A ndodh kund në botë kjo? Të nderuar deputetë ju informojmë publikisht se nëse vazhdohet me presione ndaj mësimdhënësve për të zëvendësuar orët e humbura gjatë grevës, SBASHK-u duke dëgjuar zërin dhe kërkesën e punëtorëve të arsimit të Kosovës do të shpall grevë si reagim ndaj këtyre presioneve”, është thënë në apelin e SBASHK-ut drejtuar të zgjedhurve të popullit.

SBASHK në këtë letër publike drejtuar deputetëve i ka kujtuar ata se mësimdhënësit e Kosovës janë unik në respektimin e vendimit të Këshillit Drejtues të SBASHK-ut që mos të kompensohen orët e humbura gjatë grevës as të shtunave, as në pushimin pranveror e as ndonjë herë tjetër. Ju kujtojmë po ashtu se edhe pa këto kompensime plani e programi mësimor do të realizohet së paku 90%.

## Mësimdhënësit unik duke respektuar e vendimit të Këshillit Drejtues Nuk ka kompensim orësh as në pushimin pranveror



Duke respektuar me përpikëri vendimin e Këshillit Drejtues dhe pasi kanë përcjellë me vëmendje debatin në Parlamentin e Kosovës, debat ky i një pjese të deputetëve, që ka revoltuar shumë punëtorët e arsimit, punëtorët e arsimit kanë përsëritur se nuk do ta zëvendësojnë as edhe një orë të humbur gjatë grevës. Ata kanë shprehur edhe një ehrë mbështetjen e fuqishme ndaj kryesisë dhe Këshillit Drejtues. Duke respektuar këtë zë SBASHK-u ka ripërsëritur se po fillon pushimi pranveror nga 1 prilli dhe ka uruar publikisht nxënësit për përfundimin e periudhës së dytë mësimore për t'ju uruar atyre dhe prindërve momente të bukura të pushimit me urimin që nxënësit dhe mësimdhënësit më 8 prill të rinisin angazhimet në betejat për dituri të reja.



Duke komunikuar me mësimdhënësit e Kosovës kryesia ka kujtuar se ky vit e ka shqoaruar arsimin e Kosovës me një varg sfidash, por ato janë tejkualuar falë unitetit shembullor të anëtarësisë dhe përkrahimit maksimal të kryetarit, kryesisë dhe organeve tjera të SBASHK-ut.

“Të nderuar mësimdhënës u iniciua dhe u mbajt edhe seanca e jashtëzakonshme e Parlamentit të Kosovës, por në vend të debatit konstruktiv, një numër i vogël deputetësh të subjektit politik nga vjen Ministri Bytyqi, nxorën vrerë mbi ne duke na ofenduar me një fjalorë që ua kemi lënë në fytyrën e dinjitetin e tyre. Deklaratat me fjalor të ulët të deputetëve Zafir Berisha e Zeka treguan kush janë ata dhe ndikuan që ne të jemi edhe më të fortë e më unik dhe kështu do të vazhdojmë. Ne respektojmë Ligjin e grevës dhe institucionit të drejtësisë në pritje të vendimit të gjykatës gjegjëse. Deputeti Zafir Berisha duke humbur kontrollin e të shprehurit nga inati e mllëfi u shpreh edhe kundër rritjes së koeficienteve për arsim duke përmendur se rritja është 100 euro dhe se kjo gjoja po dërguaka shtetin në kolaps. Ai bashkë me ndonjë bashkëmendimtar të tij kështu treguan se kanë qenë kundër çdo ngritjeje të koeficienteve për punëtorët në sektorin e arsimit.



SBASHK kujton deputetin Zeka se nëse ka njohuri për një organizatë kriminale që vepron në Kosovë ka për obligim ligjor, aq me tepër kur është deputet i Kuvendit të Kosovës që të iniciojë procedurë në prokurori me kërkesë që kjo organizatë të mbyllet, por nëse e ke fjalën për ne as ti e askush në botë nuk mund të gjejë as edhe një argumente sepse ne nuk jemi të tillë, po jemi nga sindikatat më të respektuara në Kosovë, Ballkan, Evropë e madje edhe në nivel të Internacionales Botërore të Arsimit, anëtarë e të cilës jemi, që nga viti 1996. Ti Zeka po të ishe në një shtet tjetër, më pakta që do të duhej të bësh kur bën këso

tjetër, më pakta që do të duhej të bësh kur bën këso akuza plot shpifje e gënjeshtër, ishte dashur të jepesh dorëheqje e të mos jesh kurrë me deputet. Të nderuar anëtarë të SBASHK-ut kërcënimet e tilla që do t'ju ndalen pagat do t'ju hiqen mëditjet e shumë e shumë tjera kemi pas dhe mund të kemi vazhdimisht por këto janë vetëm përpjekje përr t'ju frikësuar, sepse të gjitha këto janë të zgjedhur përmes Ligjit të Punës, Ligjit mbi Organizimin Sindikal, Statutin e SBASHK-ut dhe me Kontratën Kolektive”, është thënë në komunikimin e kryesisë së SBASHK-ut me anëtarësinë.

SBASHK-u ka shprehur respekt në gjithë shkresat publike për një numër të mirë deputetësh, që ishin korrekt në paraqitjet e tyre.

“Të nderuar mësimdhënës fatbardhësisht në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës shumica e deputetëve që diskutuan ishin parimor dhe në anën e zbatimit të ligjeve të cilat vetë i kanë miratuar dhe kritikuan iniciativën e thirrjes së kësaj seance të jashtëzakonshme, që si e than disa nga deputetët vërtetë është tentim për te ndërhyrë në punën dhe pavarësinë e institucioneve të drejtësisë, pasi që, siç dihet, vendimi i ministrit Bytyqi është në procedurë gjyqësore, ka vlerësuar SBASHK, për të kërkuar edhe një herë publikisht që DKA-të dhe aty këtu disa drejtora të heqin dorë nga presionet lidhur me orët e humbura gjatë grevës.